



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Ruga Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues
Dr. sc. Ali Topalli

Nr. Prot. 1423/1005
Datë 23.07.2019

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", pas shqyrtimit të kërkesës me nr. prot. 1048, dt. 24.05.2019, në mbledhjen e mbajtur më 3.7.2019, mori:

VENDIM

- I. Prof. dr. Naser Pecit, dekan i Fakultetit të Gjeoshkencave, i aprovohet kërkesa për mbështetje financiare për organizimin e Koferencës së I^{re} Ndërkombëtare Multidisiplinare mbi Gjeoshkencat (IMCG 2019), që do të organizohet në UMIB, më 10 dhe 11 tetor, 2019.
- II. Shuma e mjeteve të lejuara për këtë destinim është në lartësi deri në 8000 €.
- III. Zyra për buxhet dhe financa dhe zyra e prokurimit e UMIB-it është i obliguar të bëjë ekzekutimin e këtij vendimi në bazë të procedurave të rregullta dhe faturave përkatëse.

Arsyetim

Këshilli Drejtues pasi shqyrtoi kërkesën e prof. dr. Naser Pecit, dekan i Fakultetit të Gjeoshkencave, për mbështetje financiare për organizimin e Koferencës së I^{re} Ndërkombëtare Multidisiplinare mbi Gjeoshkencat (IMCG 2019), që do të organizohet në UMIB, më 10 dhe 11 tetor, 2019, e konsideroi të arsyeshme kërkesën për shkak se kjo konferencë ofron mundësi unike për promovimin e vlerave të institucionit, jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në nivel ndërkombëtar, ofron mundësi për kompanitë minerare për të prezantuar dhe promovuar metodologjitet, teknologjitet kërkimore bashkëkohore, shfrytëzimin e burimeve menirale, riciklimin dhe teknologjitet inovative të mbrojtjes së mijedisit.

Bazuar në këto që u cekën si më lartë, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendorit;
3. Zyrës për buxhet dhe financa
4. Zyrës së prokurimit



Dr. sc. Ali Topalli

Kryesues i Këshillit Drejtues